

KËRKESË

PËR SHPRONËSIM PUBLIK

Ministria e Financave, shpall kërkesën për shpronësim publik, të pasurive të paluajtshme, pronë private, të prekura nga ndërtimi i pikës së kalimit kufitar Vermosh.

Subjekti kërkues i këtij objekti është Ministria e Financave. Me anë të këtij publikimi në shtyp kërkojmë të vëmë në dijeni personat të cilët preken nga ky shpronësim. Vënia në dijeni konsiston në masën e vlerësimit të llogaritur nga Komisioni i Posaçëm i Shpronësimit pranë Ministrisë së Financave.

Pronarët që kanë emrat në listën emërore dhe personat e tretë, brenda 15 ditëve nga plotësimi i këtij afati për publikim, kanë të drejtë të paraqesin pretendimet e tyre të shoqëruara me dokumentet përkatëse në ministrinë kompetente (Ministria e Financave).

Për të gjithë pronarët që në kolonën shënime në tabelën e publikuar, është bërë shënimi “Plotësim dokumentacioni”, do të kompensohen për efekt shpronësimi, pasi të kenë paraqitur dokumentacionin respektiv të pronësisë pranë Ministrisë së Financave (subjekti kërkues në bazë të ligjit nr.8561, datë 22.12.1999 “Për shpronësimin dhe marrjen në përdorim të përkohshëm, të pasurisë pronë private për interes publik”). Deri në këto momente paratë do të qëndrojnë të bllokuara në bankë.

Për ato pasuri me pronar “Shtet”, për të cilat është bërë shënimi “Pretendim pronësie”, pronarët pretendentë duhet të paraqesin brenda afatit 15-ditor, dokumentacionin respektiv të pronësisë ose konfirmimin nga zyra e regjistrimit të pasurive të paluajtshme Malësi e Madhe, për të vërtetuar titullin e pronësisë, në të kundërt këto pasuri do të përjashtohen nga shpronësimi.

Vlera totale e këtij shpronësimi është 632 345 (gjashtëqind e tridhjetë e dy mijë e treqind e dyzet e pesë) lekë.

Nr.	Emër mbiemër	Njësia	Sasia	Çmimi mesatar (në lekë)	Vlera në lekë	Shënime
1	Gjokë Mark Bunjaj	m ²	1 115	623	632 345	
	Shuma gjithsej	m ²	1 115	623	632 345	

